VENDIM
Nr. 7, datë 22.1.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 299, DATË 19.10.2023, "PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE SHOQËRISË 'TRUEN' SHPK PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SAJ"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.1.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 115 prot., datë 11.1.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 299, datë 19.10.2023, për dhënien e autorizimit nga ERE shoqërisë "Truen" sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 299, datë 19.10.2023, ndër të tjera ka vendosur: 1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "Truen" sh.p.k.; 2. Ortaku i vetëm i shoqërisë "Truen" sh.p.k. bëhet "Ylliad" sh.p.k.; 3. Brenda datës 31.12.2023, shoqëria "Truen" sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE miratimin me shkrim të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. për lirimin pa asnjë rezervë dhe asnjë kusht të kuotave të saj; 4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "Truen" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe; 5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit nga ana e shoqërisë "Truen" sh.p.k. të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.

- ERE, me shkresën nr. 1959/12 prot., datë 15.12.2023, kujtoi shoqërinë "Truen" sh.p.k. që të depozitojë dokumentacionin për sa lënë kusht në vendim nr. 299/2023, brenda datës 31.12.2023.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1959/13 prot., datë 26.12.2023, depozitoi deklaratën noteriale me nr. 2507 rep., nr. 1767 kol., datë 5.12.2023, të Bankës Kombëtare Tregtare ku kjo e fundit deklaron se përfituesi/BKT-ja, heq dorë nga barra siguruese mbi kuotat e shoqërisë "Truen" sh.p.k. dhe çdo të drejtë tjetër mbi kuotat e kësaj shoqërie, meqenëse kredia për sigurimin e të cilës këto kuota janë bllokuar, është shlyer plotësisht nga kredimarrësi, shoqëria "Truen" sh.p.k.

- Me depozitimin e kësaj deklarate, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3, si e tillë nuk gjen më zbatim as pika 5, e vendimit të Bordit nr. 299/2023, ndaj vlerësohet që pikat 3 dhe 5 të shfuqizohen.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 3 dhe 5, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 299, datë 19.10.2023, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Truen" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti